

**QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË**

# **RAPORT VJETOR I PROGRAMIT**

**PROJEKTET**

**VITI 2012**

# **Projekti 1: Teknologji bashkëkohore në pentari**

**Objektivi 1. Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor të ullirit.**

## **1.1 Prova të rrënjëzimit të copave të ullirit me moshë të ndryshme. (1,2,3 vjeçare). (L.Lazaj).**

**Qëllimi:** Përcaktimi i moshës optimale të lastarit për rrënjëzim e si rjedhim shfrytëzimin maksimal të lastarëve gjysëm të drynjëzuar dhe të drynjëzuar për të marrë nga një bimë sa më shumë kalema për rrënjëzim.

Vendi i ngritjes së eksperimentit – Sera e shumëzimit Shamogjil.

Data e mbjelljes 20.03.2012

**Treguesit** që u morën:

-Numëri i copave të rrënjëzuara (% e rrënjëzimit)

**Metodika** e përdorur:

Për realizimin e studimit u ngritën tre prova:

-Prova 1- Rrënjëzimi i copave 1 vjeçare

-Prova 2- Rrënjëzimi i copave 2 vjeçare

-Prova 3- Rrënjëzimi i copave 3 vjeçare

Për çdo provë u mbollën 600 kalema dhe 1800 kalema për gjithë studimin.

U përdor teknologjia standarte e prodhimit të fidanëve me nebulizim.

Shkulja e eksperimentit u bë me 30.05.2012.

## **Konkluzione dhe rekomandime.**

E para:

Gjatë ngritjes së këtij studimi u vu re që praktikisht është e vështirë që në blloqet me ulli aq më tepër në ata që përdoren për marrje kalemash të gjesh kalema 2 dhe 3 vjeçar për shkak të krasitjeve dhe prerjeve të vazhdueshme.

E dyta:

Sic shihet edhe nga tabelat e mësipërme përqindja e rrënjëzimit të copave 2 dhe 3 vjeçare është shumë e ulët dhe e papranushme për tu marrë në konsideratë. Për këtë arsye nuk u morën treguesit e tjerë që ishin përcaktuar në metodikë si numri i rrënjëve dhe gjatësia e tyre

E treta:

Kalemat e marë nga lastarë 1 vjeçarë janë vitalë, me aftësi rrënjëzuese të lartë, (36.8%) me diferencë të theksuar me 2 provat e tjera, e si rjedhim, të vetmit që duhet të përdoren si material për shtimin e ullirit me nebulizim.

## **1.2. Përcaktimi i afateve optimale të mbjelljes së copave për rrënjëzim në banko.**

**Prova të % së rrënjëzimit në cv. Kokër madh Berati, dhe Mixan. (L.Lazaj).**

**Rëndësia dhe qëllimi:** Aftësia rrënjëzuese e copave të ullirit me nebulizim është mjaftë variable dhe varet nga shumë faktorë ndërmjet të cilëve afati i mbjelljes dhe kultivari. Nga viti në vit po shtohen sipërfaqet e mbjella me ulli jo vetëm në kodër por edhe në zonat fushore pra, kërkesat e fermerëve për fidanë janë në rritje. Duke patur parasysh këtë faktë del e domosdoshme mbjellja e serës më shumë se një herë në vit. Kjo sjell nevojën e përcaktimit të afateve të tjera optimale për mbjellje.

**Vendi i ngritjes** së eksperimentit: Sera Shamogjil

**Treguesit** që u morën:

- % e rrenjimit
- Numeri i rrënjëve.
- Gjatësia e rrënjëve.

**Metodika** e përdorur: Për realizimin e këtij studimi u bënë dy prova:

Mbjellja në muajin Mars

Mbjellja në muajin Tetor

Kultivari në provë ishte “Kalinjot”, si kultivar dominues në mbjelljet e këtij viti.

Mesatarja e % se rrënjimit për periudhën e pranverës është 38.4%.

**Prova 2.** Mbjellja u bë në 1 **Tetor**

Rrënjëzimi në total ishte i dobët .Nga sondazhet që u bënë rezultoi se rrënjëzimi ishte në masën 20%.

Kalemat e rrënjëzuar ishin me zhvillim relativisht të mirë dhe nga numërimi i 50 bimëve rezultoi : Numëri mesatar i rrënjëve 5.2 dhe gjatësia mesatare 6.3cm.

.Nuk u mboll sera në dy afatet e tjerë të parashikuar në metodikë në muajin korrik dhe dhjetor prandaj ky studim quhet i realizuar në masën 50%.

Konkluzione : Siç shihet edhe nga rezultatet e paraqitura në tabelë në pranverë aktiviteti kambial i copave është më intensiv dhe për pasojë aftësia rrënjëzuese më e lartë.

Vlerësoj që për afatet e mbjelljes së Serës të vashdojnë të bëhen prova pasi mosrespektimi rigoroz i parametrave të teknologjisë që kërkon prodhimi i fidanëve me nebulizim kompromenton rezultatin dhe nuk mund ta marim te mirqenë nëse nuk e ripersërisim.

**Aftësia rrënjëzuese e kultivarëve “K.M.B” dhe “Mixan”.**

Në muajin Mars(jashtë programit) krahas kultivarit “Kalinjot”, “K.M.B” dhe “Mixan”u vunë për rrënjëzim ne banko edhe kultivarë të tjerë autokton pasi vitet e fundit po merr prioritet shtimi i siperfaqeve të mbjella me keto kultivarë.

**Konkluzione.**

Kultivarë të vendit me rrenjzim të mirë dhe shumë të mirë janë Mixan,Kushan,,FrenguKrujes,Nisiot,UlliriKuq,Krypësi Krujes U.B.Krujë,U.B.Tiranë, K.M.Elbasanit.

Persa i përket cv. K.M.B nga prova e këtij viti, por edhe nga ato të viteve të tjera arrijmë në përfundimin se ky kultivar nuk jep rezultat në rrenjzimin me copa me anë të nebulizimit.

Do ishte me interes të provonim përqindjen e zënies që ka ne shtimimin me anë të shartimit pasi ky është kultivar i kërkuar për zonen e Beratit dhe nga me të mirët për tryezë.

**1.3. Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim duke përdorur raporte të ndryshme substrati ushqimor në qeskë.(L.lazaj).**

**Rëndësia dhe Qëllimi** i përdorimit të substrateve të ndryshëm.

Prodhimi I fidanëve të ullirit është tani prioritet I Q.T.T.B-së.Me ndërtimin e serës me nebulizim me kapacitet prodhues rreth 200000-300000 fidanë në vit është e rëndësishme të përcaktojmë substratin më të mirë mbjelljes për trapiantimin e fidanëve pas ambientimit deri në shitje.

Për këtë qëllim del e domosdoshme përcaktimi I raporteve më të mira të dheut,torfës,plehut organik,materjalit inert dhe plehut kimik të tilla që të sigurojnë substratin më të përshtatshëm për zhvillimin normal të bimes dhe me kosto me të ulët.Ai duhet të jetë i pershkueshëm me qëllim ajrosjen e sistemit rrënjor,I paster nga nematodat dhe dëmtues të ndryshëm .

**Vendi** I gritjes së studimit –Sera Shamogjil.

Treguesit që u morën:Janë tregues të rritjes dhe zhvillimit të bimes si:

1-Diametri I trungut

2-Lartësia e bimes

**Metodika e përdorur:**

Për realizimin e këtij studimi u bëne 8 prova si më poshtë:

- P1. 100% shtufë + 15 gr pleh kimik/qeskë
- P2. 40% dhe +40% shtufe+20% pleh organik
- P3. 50% dhe +25% rërë+ 12.5% torfe +12.5% pleh organik
- P4. 70% dhe + 30% shtufe + 15gr pleh kimik/qeskë
- P5. 30% dhe +70% shtufe + 15gr pleh organik/qeskë
- P6. 80% shtufë + 20% pleh organik
- P7. 80% dhe +20% pleh organik
- P8. 40% dhe +40% shtufe + 20% torfë

Për cdo provë u mbollën nga 70 bimë duke respektuar kushtet e meposhteme:

- U mbollë i njejti kultivarë - “Kalinjot’

Matja e diametrit dhe lartësisë së bimëve u bë në momentin e mbjelljes datë 30 korrik dhe e dyta në muajin dhjetor për të parë rritjen reale të bimëve.Për cdo provë u matën nga 50 bimë(Rezultatet janë mesatare e 50 bimëve të matura)

**Konkluzione dhe rekomandime:**

Siç shihet edhe nga tabela rritje më të mirë kanë fidanët e mbjellë në provën 6 (80% shtufe+20% pleh organik) ku nga 8.8 cm që ishte lartësia mesatare e fidanëve në momentin e mbjelljes,pas 5 muajsh arritën lartësin 46.6 cm,gati 5 herë me shumë.Pra substrati më I mirë është 80% shtufë + 20% pleh organik.

Substrate të mira rezultojnë gjithashtu edhe ato të provave 2,3 dhe 7 dhe respektivisht: 40% dhe +40% shtufë + 20% pleh organik; 50% dhe+25% rërë+12% torfë+12.5% pleh organik;80%dhe+20% pleh organik.

Substrati më I dobet rezulton ai I provës 1(100% shtufë+ 15gr pleh kimik në qeskë).

Nga të dhënat 5 mujore si konkluzion mund te themi që substratet mbjellës që në përbërjen e tyre kanë 15-20% pleh organik janë më të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e mirë të fidanëve .

#### **1.4. Ndikimi i përdorimit të ambalazheve të dimensioneve të ndryshme në rritjen dhe zhvillimin e fidanave të ullirit me nebulizim (L.Xhelilaj, L.Lazaj, L.Malaj.**

**Qëllimi** i këtij studimi është: Të përcaktojë madhësin optimale të qeskës (volumin e substratit) e cila siguron zhvillimin normal të fidanit pas trapiantimit deri në marrjen e fidanit standart për shitje dhe me **kosto** sa më të ulët .

Vendi i ngritjes së studimit - Shamogjin.

Studimi u ngrit në **tre** prova:

**Prova 1:** Trapiantimi në qeska 2.5 litër.


**Prova 2:** Trapiantimi në qeska 3.5 litër.

**Prova 3:** Trapiantimi në qeska 5 litër.

**Prova 1: 2.5 l**



**Prova 2: 3.5 l**



**Prova 3: 5 l**



Si konkluzion i vitit të I-rë:

Prova me rezultat më të mirë në rritjen e lartësisë së fidanit dhe të diametrit të trungut rezulton prova me dimensionin 5litër.

Të dhënat për treguesit e tjerë dhe kryesisht ato ekonomik do te evidentohen në momentin kur fidani është i gatshëm për shitje (viti në vazhdim)

## **Objektivi 2. Zbatimi i teknologjive në blloqet intensive (pemë frutore, ulli, agrume).**

### **2.1. Teknika të aplikimit të krasitjes pas vitit të dytë të mbjelljes në ullishtet intensive dhe superintensive për formimin e kurorës dhe frutifikimin e shpejtë të bimës. (Z.Veshaj).**

**Qëllimi:**Të provojme në kushtet e vendit tonë formën e mbajtjes të kurorë së ullirit në distanca të afërta mbjellje.

Çdo vit shtohen sipërfaqe të reja me ullishte intensive e superintensive duke përmirësuar nëpërmjet eksperimentacionit shkencor kultivarët më të adoptueshëm, teknologjin e mirërritjes, sasin e bimëve për ha si dhe tipet e ndryshme të mekanikës bujqësore Në kuadrin e nismës që ka marë Qeveria për mbjellien e 20 milion rrënjëve të reja ulliri në 5 vitet e ardhshëm rezultatet e këtij studim nëpërmjet këtij demonstrimi do tu shërbejë në radhë të parë fermerëve dhe institucioneve të digasterit për të informuar dhe orjentuar në hapat që duhet të hidhen në të ardhmen për zhvillimin e ullishtarisë në vendin tonë.

Studimit konsiston në ndjekjen e teknologjive te përcaktuara per parcelat e pemeve frutore , ulli e vreshta.

### **2.2. Demonstrim i teknologjive intensive (ujitje-plehrim-mbrojtje fitosanitare),në dardhë, dhe qershi si dhe në agrumishtet e reja. (Z.Veshaj).**

**Qëllimi:**Me anë të këtij demonstrimi u provua koha më optimale për ujitje,plehërim dhe mbrojtia nga sëmundjet dhe dëmtonjësit që atakojnë këto specie.

Gjatë gjithë sezonit u perdor 150 m<sup>3</sup> për çdo ujitje ose 200 litra ujë gjithsej për çdo bimë ose 60 litra ujë në çdo ujitje.per rrenje

Si pleh kimik do të përdoret N.P.K. i granuluar që do të shpërndahet para ujitjes .Sasia e plehut që do të përdoret do të jetë 3 Kv/ha ose 250 gr/bimë, ose do të përdoret për çdo bimë 80 gr/rr. në çdo ujitje.

Nga vëzhgimet tona kemi konstatuar se kultura e qershise ka patur probleme të mëdha nga infeksioni i gomozës e cila është diktuar jo vetëm në trupin e bimës por dhe në degët skeletore te rendeve të ndryshme deri në degzat një vjecare..Me gjithë nderhyrjen duke i trajtuar me preparate me bazë bakri shume nga këto bimë u thanë ose janë në këtë rugë me zhvillim të kufizuar.

Ndërsa në kulturën e dardhës u konstatua prekia nga kërpusha, merimanga dhe hiri te cilat shkakëtuan rënjen e gjetheve në muajin korrik-gush duke krijuar imazhin e rem të infeksionit nga zjarri bakterial.Me trajtimet e kryera me preparate me bazë fosfororganik (sistemi) të kombinuar me preparate për luftimin e hirit infeksioni u eliminua dhe bimët rifilluan vegjetacion te ri.


Ky demonstrim i filluar në vitin 2012 do të vazhdojë dhe për vitin e ardhshem duke hartuar paket teknologjike që do të zbatohet nga sektori i bazës prodhuese duke hequr dorë nga praktika e deri tanishme ku demonstrohen elementë të vecantë .

### **Demonstrimi i teknologjisë intensive në kulturën e Agrumeve(Ujitje,plehërim dhe mbrojtje fitosanitare) (Z.Veshaj).**

**Qëllimi:**Me anë të këtij demonstrimi do të provohet dhe përcaktohet koha më optimale për ujitje,plehërim dhe mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtonjësit që atakojnë këtë specie.

**Studimi demonstrativ është realizuar ne ndjekjen e te gjithe kartes teknologjike te percaktuar** menaxhimi ikurores, dhe tokes, ujitjen dhe përdorim e plehrave..

2-Prodhimi për çdo provë dhe përsëritje.(në rastë se ka) sepse agrumishtia është në vitin e 2-të pas mbjellies.



### **2.3. Modele tekniko – ekonomike të ullishteve.(A.Lazaj, R.Merkohitaj)**

**Qëllimi:** Njerëzit që posedojnë toka të favorshme për mbjellje të reja dhe që kanë dëshirën për ti mbjelle, te nxitur edhe nga suvencionimet e qeverisë, kanë një tendencë për ta tepruar me kultivarë të huaj të panjohur apo edhe të papërshtatshëm në zona të veçanta. Për të sensibilizuar por edhe për te treguar vlerat e vërtera të kultivarit autokton Kalinjot, shumë të përshtatshëm në zonën e jugut te vëndit tone, u mbollën në territorin e qëndrës 190 fidanë të shperndarë në tre parcela me distanca 5x5m, 5x6m sidhe në tarraca në distancën 7m bima nga bima duke mbjellë një rresht në tarracë.



Foto të parcelave mbas mbjelljes dhe nga aktiviteti i kryer me këtë rast.

### **Të dhëna për parcelat e ngritura në Shamogjil**

Në muajin Mars 2012 në parcelat e caktuara për mbelljet e ullirit u bë punimi qilizëm në thellesinë 40cm. Mbas një jave u bë frezimi i tokës për të bërë edhe nivelimin e sipërfaqes si dhe për të lehtësuar lëvizjen për piketimin dhe hapjen e gropave. Nën drejtimin e specialistëve A.Lazaj dhe R.Merkohitaj u percaktua aksi kryesor i rreshtave dhe u bë piketimi i tre parcelave dy në fushë në distancat 5x5 dhe 6x5, dhe parcela e tretë në terraca duke mbjellë një rresht në distancën 7m bima nga bima. Mbas piketimit u bë hapja e gropave 60x60x60cm. Ndërkohë u morën masat për sigurimin e hunjve mbështetës. Në çdo gropë u hodhën 5kg pleh organik si dhe 200gr NPK që u përziën mirë. Mbas kësaj u bë mbjellja duke u kujdesur për të ruajtur drejtimin e bimëve sipas piketimit dhe në fund u vendosën hunjët në thellesinë 40-50cm dhe më pas u bë lidhja e tyre. Fidanët e mbjellë ishin të një madhësie që së bashku me qeskën arrinin në 45-50cm.

Për këto u bënë matjet e lartësisë së fidanit dhe të diametrit të trungut në lartësinë 10cm mbi tokë që po i japim më poshtë.

Gjatë gjithë kësaj kohe në të tre parcelat janë kryer të gjitha shërbimet e nevojshme agroteknike. Janë kryer gjithsej dy prashitje të rrënjëve të ullirit 1x1m mbas ujitjeve, një plugim 20cm, dy kositje të barërave të zhvilluara në parcela, tre plehrime plotësuese me NPK të shoqëruara me ujitje si dhe 12 ujitje gjithsej.

Është treguar kujdes për mbrojtjen fitosanitare të bimëve duke kryer gjithsej tre trajtime me pastë bordolez, si dhe 5 trajtime me insekticide për luftimin e dëmtuesve të majës së rritjes.



Foto e parcelës në fund të vitit.

Përsa i përket përqinjes së zënive të fidanëve të mbjellë rezultoi se në të tre parcelat janë tharë gjithsej 6 fidanë (këto për pakujdesi dhe neglizhim të vadijtjes së mirë gjatë verës. Kjo e çon përqindjen e zënive në 96.8%..

Nga të dhenat e marra por edhe nga vrojtimi i gjëndjes së përgjithshme të të tre parcelave mund të themi se nuk ka ndonjë ndryshim të vërtetuar statistikisht midis parcelave.

Megjithese vihet re një diferencë shumë e vogël e rritjes në parcelën e mjellë në tarracë kjo edhe për shkak të verës shumë të nxehtë që kaluam dhe vështirësive të krijuara për ti ujitur në kohë të diferencuara të parcelave.

Konkluzioni ynë mbi të tre parcelat e marra në studim është se distancat e ndryshme të mbjelljes nuk kanë ndonjë ndikim në madhësinë e rritjes në vitin e parë të ullishteve. Në kuadër të të realizimit të rezultatis 3 (modele tekniko-ekonomike të ullishteve), të objektivit 2, të projektit 1, u ngritën në bashkëpunim edhe me D.R.B.U.M.K. Vlorë, 4 parcela “pilot”, në zona të ndryshme ekologjike të rrethit Vlorë. Parcelat u ngritën gjatë muajit mars, në fshatrat Dukat i ri,(komuna Orikum), Armen (komuna Armen), Çeprat (Shushicë), dhe Vezhdanisht (komuna Vezhdanisht). Parcelat u mbollën të gjitha me kultivarin e ullirit Kalinjot, me fidana të prodhuar në serën me nebulizim. Për sejcilën parcelë u caktuan nga ana e Q.T.T.B Vlorë, specialistët që do të ndiqnin vazhdimisht ecurinë e ullishteve të mbjella.

Nga raportet e përgatitura çdo 2 muaj nga ana e specialistëve të ngarkuar, rezulton se gjëndja e parcelave (falë kujdesit dhe shërbimeve të kryera nga ana e fermerëve, pronarë të këtyre parcelave), ka qënë mjaft e mirë. Ndryshim bën parcela në Armen, ku, largimi i pronarit për një kohë të gjatë, ka sjellë diferencim(në sensin negativ) të zhvillimit të bimëve me parcelat e tjera, ç’ka vërteton se sekretet e suksesit qëndron tek kryerja intensive e shërbimeve agroteknike.

Ecuria e këtyre parcelave do të vazhdojë edhe për vitet në vijim, për dërgjegjësimin e plotë të zhvillimit të ullishteve me fidana të kultivarit Kalinjot, me metodën e prodhimit të rrënjëzimit të copave direkte me nebulizim.

### **Objektivi 3. Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teoriko-praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore.**

#### **3.1 .Trajnime të hapura.**

<b>Data</b>	<b>Tema e zhvilluar</b>	<b>D.R.B.U.M.K.</b>	<b>Lektori</b>
<b>16.1.2012</b>	Krasitjet formuese,e prodhuese në ullinj, peme frutore vreshte dhe agrume	Tiranë	Dh.Panajoti Z.Veshaj, H.Fiku,
<b>24.2.2012</b>	1. Krasitjet formuese,e prodhuese ne ullinj e peme frutore. 2. Krasitjet formuese,e prodhuese ne. vreshte) 3 . Prodhimi i fidanave te certifikuar .	Berat	Z.Veshaj  H.Fiku  E.Spahiu, A.Llambro
<b>27.2.2012</b>	Krasitja formuese dhe prodhuese ne ullishtarine tradicionale dhe intensive	Elbasan	Z.Veshaj
<b>16.3.2012</b>	Kultivimi i drureve arnore	Tirane	A.Llambro, L.Xhelilaj
<b>12.4.2012</b>	Kriteret teknologjike per ngritjen e	Korçe	H.Fiku



	vreshtit te ri me metodat bashkekohore.		
<b>12.4.2012</b>	Format e mbajtjes se kurores ne kulturat berthamore)	Korçë	Z.Veshaj
<b>17.4.2012</b>	Kriteret teknologjike per ngritjen e vreshtit te ri me metodat bashkekohore.	Shkodër	H.Fiku
<b>7.5.2012</b>	Mbrojtja e integruar e vreshtave),	Lezhe	H.Fiku
<b>7.5.2012</b>	Menyrat me efikase te menaxhimit te fermave mikse per rritjen e efektivitetit ekonomik. ,	Lezhe	E.Brahimsulaj
<b>18.6.2012</b>	Elemente te veçante te teknologjise se kultivimit te ullishteve intensive si krasitja, ujitja, dhe plehrimi.	Fier	Z.Veshaj
<b>18.6.2012</b>	Monitorimi dhe luftimi i lulengrenesit ne kulturen e dardhes, kumbulles dhe zjari bakterial tek faroret.	Fier	A.Llambro- L.Xhelilaj
<b>2.7.2012.</b>	“Tenja minuese e agrumeve” “Breshkeza e Kalifornise” “ Syri i palloit”	Vlore	M.Baçaj
<b>1.10.2012</b>	“ Format model të bujqësisë organike	Vlorë	A.Llambro- M.Baçaj
	“ Bashkëpunimi dhe koperimi midis fermerëve, një mundësi reale për të zhvilluar ekonominë e fermës dhe rajonin. (Vlorë).	Vlorë	E.Braho L.Malaj
	“ Prodhimi i fidanave të çertifikuar”	Vlorë	A.Llambro – E.Spahiu
	“ Menaxhimi i fermës . “ Plehtrat kristalorë		A.Llambro – L.Xhelilaj

## Tabelë përmbledhëse e trajnimeve .

N/R	Problematika e temave të zhvilluara	Numuri i temave	Numuri i pjesëmarësve
1	Krasitjet dimërore të drufrutorëve	5	150
2	Prodhimi i fidanave	2	45
3	Kultivimi i drufrutorëve	3	70
4	Mbrojtja e bimëve	3	80
5	Menaxhimi i fermave	5	130
6	Plehrimi	1	30

### 3.2 Seminare.

Data	Titulli i seminarit	Vendi.	Personi përgjegjes
5.1.2012	Krasitja e ullirit	Patos	Z.Veshaj.
9.1.2012	Krasitja e ullirit	Ruzhdije	Z.Veshaj
12.1.2012	Puna për prodhimin e fidanave të ullirit në serën me nebulizim	Q.T.T.B. Vlorë	Dh.Panajoti
18.1.2012.	Krasitja e ullirit	Panaja	Z.Veshaj, A.Llambro
19.1.2012	Krasitja e ullirit	Kutë- Mallakaster	Z.Veshaj
20.1.2012 25.6- 28.6.2012	Ulliri dhe vaji i ullirit në Shqipëri Trajnim për degustimin e vajit të ullirit extra vergine (në kuader të USAID, Projekti AAC), me eksperte spanjolle.	Tiranë	A.Veizi A.Veizi, E.Spahiu
29.6.2012	Konkurs i vajit të ullirit.	Tiranë	A.Veizi, E.Spahiu.
23.8.2012	Ecuria e parcelave “pilot” të ullirit	Q.T.T.B. Vezhdanisht	Dh.Panajoti Z.Veshaj
7.11.2012	Rajonizimi dhe prodhimi i cv. Kalinjot, në qarkun e Vlores	Dukat	Z.Veshaj
20.12.2012	Kultivimi i varjetetit autokton Kalinjot me fidana të prodhuar me metoden me nebulizim në sere.	Q.T.T.B Vlore	Dh.Panajoti

### 3.3. Demonstrime e dite fushe

Data	Tema e demonstrimit	Vendi	Personi përgjegjes
18.1.2012	Krasitja në kulturën e ullirit .	Panaja	Z.Veshaj, A.Llambro
19.1.2012	Elementë të veçantë teknologjikë në ullishtet intensive dhe superintensive	Kutë , Mallakastër	Z.Veshaj

15.2.2012	-Krasitja e vreshtave me cv. hershem tavoline Victoria.	Cerkovine	H.Fiku Z.Veshaj
27.2.2102	-Krasitja e ullirit në ullishtet intensive dhe superintensive Ngarkesa optimale ne sytha ne pemtoret intensive dhe te zakoneshme	Elbasan	Z.Veshaj
6.6.2012.	Teknologjia e perparuar ne agrumishte dhe ullishte intensive.	Xare-Sarande	Z.Veshaj – H. Fiku
2.2.2012	Krasitja e ullirit	Shamogjin	Dh.Panajoti Z.Veshaj Specialistet Specialistet
16.3.2012	Krijimi i ullishteve me modele te ndryshme (aplikim distanca mbjellje te ndryshme)	Shamogjin	Specialistet Specialistet
19.3.2012	Krijimi i parcelave “Pilot”	Armen	E.Braho
20.3.2012	Krijimi i parcelave “Pilot	Vezhdanisht	Z.Veshaj
21.3.2012	Krijimi i parcelave “Pilot	Dukat	A.Llambro L.Xhelilaj M.Baçaj
23.3.2012	Krijimi i parcelave “Pilot	Çeprat	M.Baçaj
17.4.2012	Prezantim me aktivitetin e Q.T.T.B. (Me studente te U.B.T.)	Shamogjin	Dh.Panajoti, H.Fiku. A.Veizi, M.Baçaj, A.Lazaj, R.Merkohitaj
16.5.2012	Njohja me teknologjine e prodhimit te fidanave te ullirit me nebulizim.	Shamogjin	Dh.Panajoti
5.7.2012	Pjesëmarje Pjesëmarje ne Panairin rajonal (Fier	Fier	Specialiste te Q.T.T.B. Vlore
11.7.2012	Ekspoze e resurseve gjenetike autoktone te grumbulluara (	U.B.Tirane	M.Baçaj, A.Llambro, H.Fiku, L.Xhelilaj
23.8.2012	Njohja me kultivaret e rrushit	Shamogjin	H.Fiku
10.11..2012	Koha dhe menytrat e vjeljes se ullirit.	Vezhdanisht	Z.Veshaj

### 3.4 V. Woch shope.

<b>Data</b>	<b>Tema e Worch shop.</b>	<b>Vendi</b>	<b>Pjesëmarësit</b>
22-23.10.2012	Per mbeshtetjen e fuqizimit te kooperimit bujqesor ne Shqiperi.”.	Tiranë	H.Fiku, A.Llambro.
12-13.12.2012	Rritja e kapacitetit te Q.T.T.B-ve dhe sherbimit te ekstensionit per difersifikimin e projekteve rurale	Tiranë	H.Fiku, Z.Veshaj


### 3.5. Biseda ne television.

<b>Data</b>	<b>Tema e trajtuar</b>	<b>Emri i TV.</b>	<b>Personi i ftuar</b>
12.1.2012	Trajtimi i fidanave te ullirit para mbjelljes..	“Apollon”	Z.Veshaj
30.1.2012	Krasitjet dimërore në drufrutorë”	“Apollon”	R.Merkohitaj
3.4.2012	Bisede ne studio: “Prodhimi i fidanave te ullirit ne seren me nebulizim dhe mbjellja e cv. Kalinjot ne qarkun Vlore e Fier..	“Apollon”	Z.Veshaj
18.5.2012	Bisede ne studio : Problemet e kohes ne pentari.	“Apollon”	Z.Veshaj

## 4. Projekte të kërkimit në fermë.


U ngritën dhe u ndoqën normalisht 4 projekte të kërkimit në fermë.

1. Ne studimin ndikimi i polenizimit artificial në kultivarin Kallmet konfirmon në mënyrë të padiskutueshme reduktimin e fenomenit të milerandimit, e si pasojë rritjen e rendimentit mbi 20 herë. Rekomandohet :
  - a. Në vreshtat e mbjellë me kultivare Kallmet të kryhet në cdo 4-5 rreshta shartimi i një rreshti me kultivare me të njëjtë kohë lulëzimi.
  - b. Në mbjelljet e reja me kultivare Kallmet, 25 % e bimëve të mbillet me kultivare polenizues me kohë te njejte lulëzimi (Merlot).



**1. Në studimin Ndikimi i ujitje dhe plehrit në madhësinë e kurorës dhe ngarkesën në fruta në mandarinishtet e reja**

Nga provat e bëra kombinimi më i mirë është ai i: plehrit me ujitje i shoqëruar me rrallim të frutave në masën 15%.





3. Në studimin Format të ndryshme të rikonstuksionit të ullishteve të degraduara me ane të krasitjes te kryera ne tre qarqe dhe 6 ferma

a) Rikonstrukcioni i bimëve duke krasitur në masën 50 % të kurorës ne ullishtet me moshë 60-70 vjeçare

b) Rinovim total i bimës duke zbatuar krasitje ripërtëritëse në masën 70% të kurorës në ullishtet me moshë shekullore.



**4. Në studimin Forma më optimale tekniko – ekonomike te kurorave në ullishtet e reja,** tradicionale dhe intensive ngritur ne dy ferma ne Tirane , rezulton se forma polikonike e krasitjes formuese është tipi më i mirë pasi rrit sipërfaqen e ndriçimit të kurorës, ul koston e vjeljes dhe shkurton kohën e hyrjes në prodhim.




## Titulli i Projektit 2 : “Menaxhimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor”

### 1. Eksplorimi dhe grumbullimi i resurseve gjenetike në pemë frutore, ulli e hardhi

#### 1.1 Grumbullimi i resurseve gjenetike të pemëve frutore, ulli e hardhi

Gjatë vitit 2012 eksplorimi për resurse autoktone u bë në zonën e Skrapar, Mallakastër, dhe Berat. Këto zona janë zona të pasura me resurse në pemë frutore ulli e hardhi pasi kushtet klimatike janë të favorshme për zhvillimin e këtyre specieveve.


Nga eksplorimi i këtyre zonave nga grupi i specialistëve u identifikuan aksesione të reja në pemët frutore (8), ulli (3) e hardhi (4). Këto aksesione janë gjetur në kopshte dhe oborre të shtëpive në këto zona. Dallohen për prodhim të lartë dhe shije të veçantë, rezistencë ndaj kushteve klimatike, qëndrueshmëri nga sëmundje dhe dëmtues. Këto bimë janë etiketuar për marrjen e materialit në pranverë për shtimin e tyre.



#### 1.2. Studimi i aksesioneve të koleksionit autokton të pemëve frutore

Në koleksionin e pemëve frutore autoktone janë studiuar aksesionet e specieveve dardhë e kumbull. Për specien dardhë janë studiuar 14 aksesione dhe 12 aksesione për specien kumbull. Këto aksesione kanë një rëndësi të veçantë pasi janë bërthama e resurseve gjenetike autoktone me rëndësi ekonomike dhe vlera për cilësitë e veçanta të tyre. Disa nga këto aksesione me vlera të veçanta janë: dardha Elbje, dardha Gushti, dardha Dimërore, dardha Bishtje etj. Ndër aksesionet e kumbullës më të rëndësishme janë; Kumbulla Vlonjate, Kumbulla Sheqeri, Kumbulla Tropojane etje.

Ky studim do të vazhdojë dhe vitin e ardhshëm për të përcaktuar aksesionet me cilësitë më të mira.



### **1.3. Plotësimi i data base dhe i të dhënave të kultivarëve në koleksion**

Eshtë plotësuar data baza e të dhënave të pemëve frutore autoktone, hardhisë dhe ullirit.  
Ky informacion gjëndet në faqen e internetit : [www.Eurisco.al](http://www.Eurisco.al)



#### 1.4. Zbatimi i teknologjive në koleksione dhe parcela mëmë (pemë frutore, ulli e hardhi)



##### LEGJENDA

1. Serra e fidanave ulli
2. Fushat e rritjes
3. Parcele meme ulli
4. Koleksion agrume
5. Fidanishte ulliri
6. Parcele meme bajame
7. Ulli autokton
8. Pentore meme dardhe
9. Pentore meme qershie
10. Pentore meme kajsi
11. Pentore meme pjeshke
12. Parcela e fares
13. Parcela per copa vegjetative
14. Pentore intensive
15. Koleksion autokton pemë frutore.

**Baza eskperimentale/prodhuese Shamogjin** është qenda e ruajtjes së germoplasmës të vendit e të huaj dhe e zbatimit të teknologjive bashkëkohore. Këtu gjendet një pasuri varietore në pemë frutore, ulli, agrume e hardhi të mbjella në koleksione. Menaxhimi i tokës është element i rëndësishëm në këtë bazë.

Në një pjesë të sipërfaqes së tokës përdoret herbicidi (në rresht dhe në skarpatat e tarracave). Në mes të rreshtave lihet tapet bari i cili kositet shpesh.

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së mbjellë është nën ujë. Këtu përdoret ujitja me pika e cila ka një efikasitet më të madhe krahasuar me sistemet e tjera të ujitjes. Në rreth 12 ha është shtirë impianti i ujitjes me pika. Nunri i ujitjeve arin dhe 8.-10 ujitje në kodër tek agrumet.

Gjithashtu përdorimi i ujitjes me plehërim përfaqëson një faktor kyç. Përdorimi i plehrave në ujitje ka dhënë rezultate në zhvillimin e kurorave të pemëve deri në 30% më shumë.


Mbrojtja fito sanitare është e përqëndruar në dy momente kryesore: monitorim dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në gjitha kulturat e mbjella.

Kombinimi i luftës së integruar me ato biologjike është objektivi kryesor për mbrojtjen e bimëve në parcelat mëmë dhe koleksione.

Elementë të tjerë të rëndësishëm në këtë territor janë pemtoret mëmë të drufrutorëve bërthamore, të ullirit dhe hardhisë autoktone, të cilat shërbejnë për marrjen e materialit për shtim

Q T T B Vlorë prodhon material të kategorive të larta ( pemë frutore, ulli e hardhi) për fidanishtet.

Nga pemtoret mëmë të ullirit në jo vetëm plotësojmë nevojat tona me rreth 150.000 lastarë për prodhimin e fidanëve të ullirit me nebulizim në serrë por dhe kërkesat e fermerëve të zonës







## 2. Çertifikimi i materialit bimor të ullirit.

2.1.Në vitin 2012 morën rëndësi ullishtet mëmë .Përveç ullishteve ekzistuese u shtuan ullishte mëmë me parametra të teknologjisë së lartë .

Lidhur me këtë zhvillim këto parcela u vunë nën kontroll

- për syrin e palloit
- për verticiliozen ( pamje vizuale)
- për turbekulozin

Me një protokoll vjetor u realizuan trajtime sistematike për sëmundje e dëmtues kryesor si tenja e ullirit, syri i palloit,hundëgjati, këpusha (aceria) Kontrolli vizual dhe trajtimet kimike u mbështeten me analiza laboratorike në bashkëpunim me Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve të U. B. T me të cilin po bëhen përpjekje për të krijuar një protokoll aktivitetesh për parambrojtjen dhe identifikimin e parazitëve.



### **.Titulli i projektit 3 : “Studim, Projektim dhe Modelim ferme ne pentari “**

Sektori i “Modelimit dhe analizës në fermat e pentarisë” pranë QTTB Vlorë prej 4-5 vjetësh ka bërë një seri studimesh në këtë fushë si për: tendencën e zhvillimit të fermës së pentarisë në mbjelljet e reja, efektivitetin e kultivimit të ullirit në fermat e rrethit Vlorë, për prodhimin e fidanave frutorë në zonën e ulët dhe bregdetare, për modele tekniko-ekonomike të fermës së pentarisë në zona të ndryshme mbi nivelin e detit, për epërsitë ekonomike të fermave intensive të pentarisë etj.

Me informacionet e transmetuara tek aktorët e interesuar dhe veçanërisht tek fermeri ynë, për rezultatet e këtyre studimeve nëpërmjet: trajnimeve, divulgimeve, takimeve zonale, mediave vizive dhe të shkruara, botimeve të ndryshme dhe faqes tonë në internet, shpresojmë të kemi kontribuar për përmirësime në: drejtimin dhe organizimin e fermës, përshtatjen e strukturës së prodhimit me kërkesat e konsumatorit dhe të tregut, krijimin e modeleve të përshtatshme të fermave sipas kushteve specifike klimatiko-tokësore të zonave të ndryshme si dhe, për rritjen e cilësisë së prodhimit tonë dhe të konkurrueshmërisë së tij edhe në tregje ndërkombëtare, në përshtatje me normat ligjore të Bashkimit Europian.

Edhe gjat vitit 2012 ky Sektor ka kryer 4 studime me të njëjtin objektiv : studimi i efektivitetit të prodhimit në fermat e pentarisë.

Secili nga studimet do të prezantohet më poshtë në formë ekstrakti por, duke evidentuar plotësisht problematikat dhe këshilluar zgjidhje të mundshme për to.

#### **6.Objektivat dhe rezultatet kryesore:**

**Studim 1: Produktiviteti i prodhimit të ullishteve të zakonshme dhe intensive për vaj.**

**Objekti: Studime të efektivitetit ekonomik në pentari**

**Rezultatet:**

Qëllimi i studimit: Zhvillimi dhe kolaudimi i strategjive të menaxhimit të përshtatshëm në kushte të ndryshme kulture dhe sociale, në gjëndje të prodhimit të mira ekonomike për fermat, shpesh me investime të kufizuara. Përcaktimi i disa teknikave produktive për rritjen e efektivitetit të prodhimit.

Studimi u krye në Komunën e Novoselës për kultivarin Kalinjot. Të dhënat u morën për vitet: 2010 dhe 2011. Fermat u zgjedhën me qëllim që të përfaqësonin kushtet e kultivimit të këtij varieteti në këtë zonë ullishtarie.

Janë studiuar treguesit e produktivitetit të teknikave prodhuese për: ha, kv ulli, kv vaj, rrënjë, mekanikë, bazë materiale, krah pune dhe janë përcaktuar variablet e mundshme për rritjen e tij.

Karakteristika të fermës

Nga të dhënat rezulton se 65 % e fermave të studiuara janë familjare, karakteristikë e menaxhimit të kësaj ullishtarie me sipërfaqe e numër rrënjësh të kufizuara. Vetëm 20 % e fermerëve punësojnë të tretë për të plotësuar nevojat e prodhimit.

Sipërfaqja për fermë e mbjellë me ulli shkon rreth 0.8 ha, ndërsa në prodhim 0.5 ha.

Rreth 85 % e saj shtrihet në kodra të larta. Mbizotëron tipi i ullishteve me 110 bimë/ha,

mbi 50 vjeçare dhe pothuajse e tëra mbi ujë. Përgjithësisht ferma ushtron aktivitetet të përzier dhe realizon përafërsisht: 29 kg/rrënjë ulli dhe 6 kg/rrënjë vaj ulliri. Familja fermere konsumon në vit: 2 kv ulli dhe 0.9 kv vaj ose përkatësisht: 40 kg/frymë ulli dhe 18 kg/frymë vaj ulliri.

Të ardhurat nga ullishtaria zënë vetëm 44 % të të ardhurave gjithsej. Për të dy tipet e ullishteve (tradicionale dhe tradicionale intensive), ferma, në veprimtarinë e saj prodhuese, rezulton me humbje. Për çdo rrënjë ulli shpenzohet mesatarisht 2971 lekë ose më pak se 2 ditë pune dhe fitohet 2281 lekë.

Në kushte të përafërta prodhimi, 25 % e fermave të studiuara rezultojnë me bilanc pozitiv.

#### 1. Menaxhimi i tokës në ullishte

Referuar të dhënave rendimenti i punës është më i lartë se koha që mund të përdoret normalisht përkatësisht: për punimin 3 herë, kultivim + frezim 4 herë dhe spërkatjen me rreth 2 herë. Në 25 % të fermave që rezultojnë me bilanc pozitiv, për punimin dhe frezimin, treguesit më sipër rezultojnë produktiv me 6 orë/ha më pak dhe rendimenti është 45 % më i lartë.

#### 2. Krasitja e ullirit

Së bashku me vjeljen zënë rreth 58 % të shpenzimeve të prodhimit gjithsej. Sipas të dhënave, për kryerjen e këtij operacioni duhen 1.6 orë/rrënjë.

Me mjete mekanike të thjeshta (gërshërë dhe sharra pneumatike) rendimenti është 40-50 % më i lartë dhe shpenzohet 45 minuta/rrënjë, duke rritur produktivitetin rreth 4 herë dhe ulur koston në 208 lekë/rrënjë nga 464 lekë që është me metodën tradicionale të krasitjes.

Sjellja e volumit të kurorës së ullirit me përmasa normale (50-70 m<sup>3</sup>), përveç rritjes së produktivitetit të kryerjes së këtij procesi me efektet pozitive që përmendëm, rrit me rreth 2-3 herë sasinë e prodhimit kg/m<sup>3</sup>. (Panajoti Dh.2005).

#### 3. Vjelja e ullirit

Për ullishtet që ne kemi studiuar edhe ky proces kryhet tërësisht me krahë, në kushte mjaft të vështira terreni, në bimë me volume kurore 140-170 m<sup>3</sup>, në përgjithësi, të pa menaxhuara rregullisht.

Rendimenti i punës së vjeljes me krahë, krahasuar me mënyrat e tjera, është mjaft i ulët. Përdorimi në masë më të gjërë i teknikës së thjeshtë të vjeljes me krëhëra plastik do të kursente e 23 ditë pune/ha. Ndërsa me interes ekonomik shumë të lartë do të rezultonte përdorimi i mjeteve të vjeljes mekanike, të menaxhuara nga puntori, që rrisin produktivitetin për orë pune 3- 6 herë dhe ulin koston me rreth 700 lekë/rrënjë krahasuar me vjeljen me dorë.

#### 4. Grumbullimi i prodhimit

Vetëm duke rritur sipërfaqen e rrjetës nga 24 m<sup>2</sup> në 96 m<sup>2</sup> ulet gati 3 herë kosto orare për kv ulli dhe po kaq rritet rendimenti i puntorit në ditë. Duke përdorur tipin e dytë të rrjetave ulet 4 herë numri i puntorëve për të vjelë 140 rrënjë ulli ( nr.bimëve/ha), duke kursyer 538 lekë/rrënjë ulli shpenzime për grumbullimin e prodhimit.

## **Studimi 2: Ndikimi i elementeve të teknologjise në koston e prodhimit të ullirit Kokërrmadh Beratit.**

**Objekti:** Studimi i kushteve tekniko ekonomike të ullirit për kripje në zonën e Beratit.

### **Rezultatet:**

Qëllimi i studimit: Të dhënat që do të evidentohen mund të kontribuojnë për të përcaktuar rrugë të mundshme veprimi dhe ndërhyrje për të ulur koston dhe rritur efikasitetin e prodhimit.

Studimi u krye në 85 ferma të komunave Pajovë dhe Kumanovë, ku shtrihet sipërfaqja më e madhe e këtij kultivari në qarkun e Beratit. Fermat e përzgjedhura për të marrë të dhënat, përfaqësojnë në përgjithësi, kushtet e shtrirjes së terrenit të këtij kultivari. U morën në analizë të dhënat e vitit 2011, kohë në të cilën nuk ishte vjelë akoma prodhimi i vitit 2012.

Analizuam këta tregues: tipin dhe strukturën e fermës, teknologjitë e zbatuara gjatë vitit të analizuar, baza materiale e përdorur dhe destinacioni i prodhimit, në funksion të arritjes së objektivit të studimit: evidentimi i peshës së elementëve të koston në strukturën e saj dhe mundësitë e ndërhyrjes për rritjen e efektivitetit të aktivitetit të fermës së ullishtiarisë.

Nga të dhënat e studimit rezulton se 100 % e fermave të përfshira në studim janë familjare, me aktivitet të përzier. Nga sipërfaqja në pronësi e fermerit, K.M i Beratit zë rreth 25 % të saj. Sipërfaqja për fermë është 2.1 ha, ndërsa e zënë me ulli K.M.B, 0.5 ha. Nga totali i fermave 37 % kanë mbi 1 ha/fermë. Mosha e ullishteve është mbi 50 vjeçare dhe 40-50 vjeçare. Ullishtet janë tradicionale me rreth 177 bimë/ha. Nga sipërfaqja e mbjellë 36 % shtrihet deri 15 % pjerrësi, pjesa tjetër deri 25 % pjerrësi dhe e gjitha mbi ujë. Për çdo rrënjë merret 31 kg ulli.

#### **1. Të ardhurat dhe shpenzimet**

Nga të dhënat del se aktiviteti i prodhimit të ullirit për kripje (K.M i Beratit), rezulton me fitim. Në totalin e fermave 11 % e tyre fitimin e kanë 18 % më të lartë se mesatarja e të gjitha fermave të marra së bashku. Të ardhurat për ha arrijnë mesatarisht 2270 €, ndërsa shpenzimet 1020 €. Të ardhurat neto për fermë shkojnë rreth 250 €/frymë në vit. Për çdo rrënjë ulli shpenzohet 1783 lekë dhe fitohet 3143 lekë (çmimi i shitjes 100 lekë/kg).

Duhet të theksojmë se pothuajse asnjë fermë e studiuar nuk është e specializuar në kultivimin e kulturës së ullirit K.M i Beratit dhe sipërfaqja mesatare për fermë e mbjellë me ulli është gati 4 herë më e vogël se sipërfaqja në pronësi e fermerit.

#### **2. Struktura e koston së prodhimit**

Në kultivimin e ullirit për kripje punimet me krahë dhe baza materiale janë dy zërat më të kushtueshëm të koston. Ato zënë 93 % të shpenzimeve totale, e barabartë me 1555 lekë/rrënjë ose 87 % të shumës së koston totale të shpenzimeve të punës së krahut për bimë. Punimet me mekanikë zënë vetëm 7 % të shpenzimeve gjithsej. Këtë e pasqyrojnë dhe shpenzimet për ha që janë më të ulta se: shpenzimet për punimet me krahë gati 1.5 herë dhe 1.2 herë krahasuar me shpenzimet për bazë materiale. Punimet me mekanikë kryhen në rreth 1/2 e sipërfaqes dhe në 72 % të numrit të bimëve.

### 3. Punimet me krahë

Tek punimet me krahë proceset e krasitjes, vjeljes dhe punimit poshtë kurorës zënë 75 % të shpenzimeve. Janë operacionet që kanë koston e prodhimit më të lartë për rrënjë, ku shpenzohen

77 % e ditëve të punës për këtë zë të koston. Punimet e tjera të kryera me krahë si: shpërndarje pleh organik dhe kimik, spërkatje me herbicid dhe kositje bari etj, nuk kanë influencë në koston e prodhimit.

Puntori për 1 ore: krasit 1.3 rrënjë ulli, grumbullon dhe eleminon mbetjet e krasitjes në 0.3 dn, shpërndan pleh organik në 11 rrënjë, punon nën kurorë 1.6 rrënjë, shpërndan plehun kimik në 16 rrënjë, vjelë 41 kg ulli dhe kosit 0.5 dn.

Në pothuajse të gjitha operacionet e mësipërme mund të kryhen punime me mekanikë, të cilat do të shumfishonin produktivitetin e këtyre teknikave dhe do ta bënin fermën më rentabël. P. sh. në qoftëse do të siguroheshin mjete të përshtatshme për punimin e tokës së ullishtes në kushtet e terrenit ku shtrihet, rreth kurorës do të ngelej për të punuar me krahë 20-25 % e saj. Në këtë rast puntori, për të punuar një rrënjë nuk do të kërkonte 36 min/rrënjë por vetëm 15-20 minuta ose gati 1 herë më pak. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për proëset e tjera, sidomos për vjeljen dhe krasitjen.

### 4. Punime me mekanikë

Punimet me mekanikë kryhen në 45 % të sipërfaqes dhe në 64 % të numrit të rrënjëve. Ato mungojnë plotësisht në proceset kryesore si punimi i tokës, krasitja dhe vjelja e ullirit. Përdorimi i mjeteve mekanike ul 5 herë shpenzimin e ditëve të punës për ha, krahasuar me punimet me krahë.

Punimi i tokës me mekanikë kushton 52.6 % më pak se me krahë, duke ulur shpenzimet totale për rrënjë nga 168 lekë në 94 lekë. Me anë të spërkatjeve të mekanizuara arrihet të trajtohen 60-70 rrënjë në ditë ulli nga 15-20 rrënjë që trajtohen me krahë. Në procesin e dizerbimit apo të kositjes së barit me mekanikë, për menaxhimin e vegjetacionit në ulli, shpenzohet 1 ditë pune për ha nga 5 ditë pune që duhen për menaxhimin e tij me krahë. Mekanizma të thjeshtë si: krehra dhe gërshërë pneumatike apo elektrike rritin rendimentin në vjelje dhe krasitje 35-40 %, duke dëmtuar frutin e ullirit 5-6 % ose në 31 kg ulli që merren për rrënjë dëmtohet rreth 1.2 kg, duke humbur 4 % të të ardhurave për rrënjë, por duke reduktuar shpenzimet me 39 %.

### 5. Përdorimi i bazës materiale

Janë shpenzime që ngrenë peshë në koston e prodhimit, me rreth 41 %. Brënda këtij zëri të koston shpenzime më të larta janë bërë për plehra kimik dhe pesticide që zënë rreth 80 % të totalit. Nga studimi rezulton se janë përdorur për rrënjë : 83 kg pleh organik, 3 kg pleh kimik dhe për ha : 5.4 kg pesticide dhe 4.3 kg herbicide. Pothuajse 100 % e fermave kanë kryer plehrim organik, kimik dhe trajtime antiparazitare, ndërsa vetëm 15 % kanë përdorur trajtimin e vegjetacionit në ulli me herbicid, si mënyrë luftimi. Efënca e të gjitha fermave të studjuara tregon se përdorimi i bazës materiale është bërë me cilësi, sasi dhe në kohën e duhur.

### **Studimi 3: Ndërthurja e elementëve tekniko-ekonomik në projektet e ullirit që subvencionohen**

**Objekti:** Studimi i ecurisë dhe tendencës së komponentëve të mbjelljeve të reja.



## **Rezultatet:**

Qëllimi studimi : Evidentimi i tendencës së zhvillimit të ullishtarisë drejt intensifikimit të prodhimit

Në studim u përfshinë rreth 5700 ferma të qarqeve: Vlorë, Fier, Berat, Gjirokastrë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Lezhë, Shkodër. Për marrjen e të dhënave bashkëpunuam me Drejtoritë e Bujqësisë në qarqe. Me të dhënat e grumbulluara u krijua një baza e të cilin u punua për evidentimin dhe përpunimin e të gjithë elementëve të duhur. Objekt i studimit ka qënë rrethi dhe qarku.

U studiuan këta tregues: sipërfaqet e mbjella, tipi i ullishteve: tradicionale, intensive dhe superintensive, numri i bimëve për ha, raporti kultivarëve autoktone me kultivarë të huaj, kosto e mbjelljes sipas tipit të ullishteve, niveli i investimit nga fermeri dhe sipërfaqja e subvencionuar nga shteti.

### **1. Sipërfaqet dhe numri i rrënjëve të mbjella**

Sipas të dhënave gjatë vitit 2012 janë mbjellë 1711.93 ha, ku 77 % e sipërfaqes së mbjellë është subvencionuar nga shteti dhe 23 % e saj është investim i fermerit.

Në 9 rrethe mbjellja e ullirit është mbështetur tërësisht nga shteti dhe në 4 të tjerë është subvencionuar 80-90 % e mbjelljes. Në rrethet ku ulliri është bimë tradicionale si: Vlorë dhe Fier investimi nga fermeri shkon nga 50-75 %. Por edhe në rrethe me më pak traditë në këtë sektor si: Gjirokastra, Lezha dhe veçanërisht Shkodra, fermerët kanë investuar për mbjelljen e 24-29 % të sipërfaqes. Edhe gjatë këtij viti mbjelljet e bëra në qarqet : Vlorë, Fier, Berat dhe Elbasan zënë 71 % të sipërfaqes së mbjellë në shkallë vendi.

Në mbjelljet e vitit 2012 kultivarët e huaj zënë 70 % dhe ata autoktone 30 %. Në tre qarqet më të mëdha të ullishtarisë: Vlorë, Berat dhe Fier, kultivarët e vendit kanë zënë 35-50 % të sipërfaqes së mbjellë gjithsej. Ndërsa varietetet e huaj, në fakt, zënë një përqindje të konsiderueshme të mbjelljeve të këtij viti në qarqe ku ullishtaria po shtrihet rishtas si: Gjirokastrë, Shkodër dhe Lezhë. Në këtë aspekt bën përshtypje dhe përqindja e lartë e sipërfaqes së mbjellë me kultivarë të huaj në qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit (77 %, 93 % dhe 69 %), duke mënjeluar kultivarët autoktone të rajonizuar si: ulliri i Bardhë dhe i Zi i Tiranës, i Bardhë i Durrësit apo Krypsi i Krujës etj. me vlera të larta ushqimore si për kripje dhe për vaj.

Ulliri është mbjellë me 350 bimë/ha ku: kultivarët e vendit me 304 bimë/ha, ndërsa të huajt me 370 bimë/ha. Në qarqet Tiranë e Durrës, për dendësi e mbjelljeve të realizuara (520-530 bimë/ha), ullishtet mund të konsiderohen plotësisht intensive, një praktikë që duhet evidentuar, promovuar dhe përhapur. Të tillë teknologji mbjellje kanë zbatuar dhe qarqe me më pak përvojë si Shkodra (400 bimë/ha).

### **2. Struktura e kultivarëve**

Struktura e kultivarëve të mbjellë është: 7 kultivarë autoktone dhe 9 të huaj.

Tek kultivarët e vendit sipërfaqe më të mëdha janë mbjellë me Kalinjot (36.7 %), Mixan (22.5 %) dhe KM Beratit (23.9 %). Mbas tyre rendite : Ulliri Bardhë i Tiranës, ulliri Bardhë i Krujës dhe Nisioti. Varietetet e tjera kanë sipërfaqe të vogla. Gjatë vitit 2012 nuk është mbjellë asnjë ha me varietetin Kokërrmadh i Elbasanit.

Në aspektin e destinacionit të prodhimit : për vaj mbizotëron kultivari Kalinjot me 45.8 % dhe Mixan me 29.8 %. Ndërsa tek kultivarët për kripje Kokërrmadh i Beratit me 98.7 %.

Nga kultivarët e huaj, në mbjelljet e këtij viti, janë preferuar: Frantoio (74 %), Leccino (14.8 %) dhe Arbequina (7.5 %).



### 3. Tipi i ullishteve

Është një nga elementët e studiuar për të evidentuar rrugën e zhvillimit të ullishtarisë dhe për të pasqyruar këtë realitet për vitin 2012.

Gjate këtij viti asnjë fermer nuk ka mbjellë sipërfaqe me ulli nën 250 bimë/ha, sa për kriteret e vlerësimit për të përfituar mbështetje financiare dhe si rezultat i zbatimit të teknologjive bashkëkohore në ndërtimin e ullishteve të reja.

Janë verifikuar tre tipe ullishtesh: tradicionale, intensive dhe superintensive. Mbjellja e 48.5 % të sipërfaqes gjithsej me ullishte intensive tregon tendencën mjaft pozitive të zhvillimit të këtij sektori. Inkurajues është dhe fakti që janë mbjellë 34 ha ullishte superintensive, për shtrirjen e të cilës në vendin tonë nuk mungojnë zonat me kushte klimatiko-toksore shumë të përshtatshme dhe përcaktimet e duhura tekniko-organizative për realizimin e tyre.

### 4. Kostot e mbjelljes

Në përlllogaritjen e kostos së mbjelljes janë përfshirë tipet më përfaqësuese të ullishteve. Shpenzimet e mbjelljes për 1 ha ulli janë shifra orientuese që do t'i shërbejnë fermerit për llogaritjen e investimeve për tipe të ndryshme ullishtesh.

Nga të dhënat del se, për të tre tipet e këtyre ullishteve, 71 % të shpenzimeve e zë baza materiale. Peshën më të madhe në këtë zë të kostos e kanë shpenzimet për fidana ulliri dhe pleh organik. Për të tre këto kategori ullishtesh niveli mekanizimit është akoma i ulët. Shpenzimet për kryerjen e punimeve me mekanikë zënë vetëm 21 % të totalit. Ndërsa struktura e shpenzimeve të zërave të kostos për punën e krahut, për të gjitha tipet e ullishteve, është pothuajse e përafërt.

## **Studimi 4: Promovimi i verërave të kultivarëve autoktonë të rrushit**

**Objekti: Vlerësimi enologjik i produktit në kultivarët e rrushit autoktonë.**

### **Rezultatet:**

Qëllimi: Të vlerësohen nga pikëpamja e vlerave enologjike 5 kultivarët autoktonë të rrushit.

Kultivarët në studim: “Shesh i zi”, “Shesh i bardhë”, “Kallmet”, “Debin e bardhë, dhe “Vlosh”.

Vëndi i marrjes së rrushit: Baza eksperimentale prodhuese: Shamogjin.

Duke qënë se në bazën tonë eksperimentale prodhuese, është mbjellë për qëllime studimore një sipërfaqe vreshti prej 2.4 ha, me 5 kultivarë autoktonë, nga më të rëndësishmit dhe më të përhapurit në vendin tonë, u ndërmor ky studim për të bërë vlerësimin e tyre nga pikëpamja enologjike.

Metodologjia që u përdor:

Vjelja e rrushit u krye në pjekjen e plotë të çdo kultivari, pas verifikimit të ecurisë së grumbullimit të sheqerit me refraktometër (momenti kur refraktometri nuk tregonte më ritje të sheqerit krahasuar me matjen e mëparëshme).

Për çdo kultivar u morën për përpunim sasi rrushi, për të përftuar jo më pak se 40 litra verë.

U zbatuan të gjithë parametrat shkencore si dhe të gjitha hallkat teknologjike të prodhimit të verës duke filluar nga shtypja, fermentimi, toçitja, kullimi etj. Për çdo kultivar u përdorën enë të veçanta fermentimi.

Në përfundim, për çdo kultivar u prodhuan nga 50 shishe vere me dimensione  $\frac{3}{4}$  litra. Promovimi dhe vlerësimi i tyre për çdo kultivar do të bëhet gjatë muajit prill 2013, (pasi të jete kryer maturimi i plotë i saj), nga një komision degustatorësh të specializuar. Ndërkohë verërat janë të ambalazuara në shishe qelqi të errëta dhe të etiketuara për çdo kultivar.

Në varësi të buxhetit të vitit 2013, për të kompletuar studimin, do të shihet edhe mundësia e kryerjes së analizave kimike të të pesë llojeve të verërave të prodhuara.

#### Menaxhuesit e projekteve

Nr	Menaxhuesit	Funksioni	Kultura
1	Ipokrat Fiku	Pergjegjes i sektorit te Teknologjive ( Agronom)	Hardhi
2	Adhurim Lazaj	Pergjegjes sektorit menaxhimit te Resurseve gjenetike ( Agronom)	Peme frutore autoktone
	Enver Braho	Pergjegjes sektori Analiza dhe modelimi i fermes ( Agronom)	Analiza dhe Modelim Ferme
3	Dhimiter Panajoti	Drejtor ( Agronom)	Ulliri
4	Athina Llambro	Drejtoresh e Drejtorise se Teknologjive( Agronom)	Peme frutore autoktone
5	Zaim Veshaj	Pergjegjes Departamenti (( Agronom)	Peme frutore
6	Lida Lazaj	Specialiste ( Agronom)	Pradhimi i fidaneve
7	Lumturi Xhelilaj	Specialiste ( Ekonomist)	Analiza dhe Modelim Ferme
8	Luljeta Malaj	Specialiste ( Ekonomist)	Analiza dhe Modelim Ferme
9	Aulona Veizi	Specialiste Laboratori	Prodhimin e vajit
10	Elektra Spahiu	Specialiste Laboratori	Analiza kimike
11	Nikoleta Mone	Specialiste Laboratori kimik	Analiza kimike
12	Ramo Merkohitaj	Specialiste ( Agronom)	Bazat
13	Mendim Baci	Specialist Mbrojtje bimeve	Bazat

#### 7. Bashkepunimi me institucionet

Ne raport eshte pershkruar nje bashkepunim efikas me USAID-AAC ne baze te nje memorandumi me MBUMK, ne fushen e transferimit te teknologjive. Jane kryer shume trajnime dhe seminare, ku nder me te rendesishmit eshte Konferenca e Vajit te Ullirit ne

mars 2011. Eshte dhene nje kontribut i rendesishem teknik ne Komunen Xare - Mursi per zhvillimin e Klementinave ne kete zone

Kemi realizuar nje bashkëpunim efektiv me IBB ne ullishtari, me prodhimin organik te ullirit, certifikimin ne fushe dhe përpunim dhe nxjerrjen e produktit vaj organik nga parcelat tona. Parashikojme qe bashkëpunimi te shtrihet edhe ne vreshtarine me kultivare autoktone.

Me CNR IVALSA, CRA- Rome, vazhdojme te kemi shkëmbime teknike dhe transferim teknologjie per ullirin dhe shumëzimin e materialit bimor.

## **8. Projektet**

1. RESGEN- “Ruajtja, karakterizimi, koleksionimi dhe perdorimi i resurseve gjenetike te ullirit” COI 2011-2012
2. Projekti me MASH 2012-2014: “Aplikim ne industrine ushqimore i sistemeve sensoriale inovative per analizat e vajit te virgjer te ullirit qe certifikojne cilesine, kontrollin dhe sigurine ushqimore” IVALSA- Firenze, Itali.

## **9. Bazat e teknologjive te komunikimit dhe informacionit**

Q T T B është përfshirë në një projekt UNJP/006/ALB/UNJ mbi forcimin e lidhjeve funksionale dhe ndertimi i kapacitetve midis aktoreve te kerkimit shkencor kombetar dhe sistemeve te ekstensionit per ti siguruar sherbime efektive fermerëve ne te gjithë Shqiperine.

Q T T B Vlore brenra ketij rrjeti ka faqen e saj zyrtare me nje srukture te percaktuar Nga Q T T B Vlore eshte futur nje pjese e informacinit dhe ai freskohet sipas problematikes se kohes. Keto informacione mund te gjeni ne adresen [www.agro.al](http://www.agro.al); [www.mbumk.gov.al](http://www.mbumk.gov.al)